

REPUBLICA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT
TIRANE
Nr. 19098 Akti.

19098

V E N D I M

PER RREGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Sot me date 14.01.1998, une, Gjqqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, Vllamasi, pasi studiova materialet e paraqitura nga Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "GERVIS" me themelues Zoterinjte Fatos VLLAMASI, banues ne Tirane, rruga "Budi", pall.58/2, ap.13, dhe Bardhyl VLLAMASI, banues ne Tirane, rruga "Budi", pall.58/2, ap.13:

K O N S T A T O V A

se "GERVIS" sh.p.k. Tirane., themeluar nga Fatos VLLAMASI dhe Bardhyl VLLAMASI, banues ne Tirane, kane paraqitur kerkese per tu rregjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane si Person Juridik.

Veprimtaria e Shoqerise eshte:

- shrypshkrime te ndryshme;
- ndertime dhe rikostruksione te niveleve te uleta;
- import-export dhe shitje me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale , blegtorale dhe ushqimore te te gjitha larmive;
- import-export dhe shitje me shumice e pakice te teknikes se bardhe dhe te zeze;
- importimin e pjeseve te kembimit per automjete si dhe ngritjen e serviseve per automjete te vogla, te medha dhe makinerive bujqesore;
- import dhe shitje me shumice e pakice te makinerive, paisjeve e veglave te punes per fusha te ndryshme teknologjike, si ne fushen e ndertimit, industrise, bujqesise, hotelerise, etj;
- import dhe shitje me shumice e pakice te makinerive e paisjeve elektrike dhe elektronike si per industri, bujqesi, ndertim ashtu edhe per perdorim te lire publik;
- ngritjen dhe shfrytëzimin e restoranteve, bareve e kafeneve.

Selia do te jete ne Tirane, rruga "Budi", pall.58/2, ap. 13.

Afati i veprimtarise mbi 10 vjet.

Kapitali fillestar do te jete 100.000 (njqintemije) leke.

Kryetar i Asamblese se Ortakeve do te jete Z.Fatos VLLAMASI.

Administrator i Shoqerise emerohet Z. Bardhyl VLLAMASI.

Nga materialet e paraqitura rezulton se veprimtaria e Shoqeris eshte ne perputhje me kushtet e kerkuara me ligj dhe per rrjedhim kerkesa pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Nenit 5 te Ligjit Nr.7512, date 10.08.1991 dhe te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

V E N D O S A

Rregjistrimin ne Gjykate te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "GERVIS", themeluar nga Fatos VLLAMASI dhe Bardhyl VLLAMASI, me seli ne Tirane per te ushtruar veprimtarine si Person Juridik sipas objektit te paraqitur.

Objekti i veprimtarise se saj do te jete:

- shrypshkrime te ndryshme;
- ndertime dhe rikostruksione te niveleve te uleta;
- import-export dhe shitje me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale , blegtorale dhe ushqimore te te gjitha larmive;
- import-export dhe shitje me shumice e pakice te teknikes se bardhe dhe te zeze;
- importimin e pjeseve te kembimit per automjete si dhe ngritjen e serviseve per automjete te vogla, te medha dhe makinerive bujqesore;
- import dhe shitje me shumice e pakice te makinerive, paisjeve e veglave te punes per fusha te ndryshme teknologjike, si ne fushen e ndertimit, industrise, bujqesise, hotelerise, etj;
- import dhe shitje me shumice e pakice te makinerive e paisjeve elektrike dhe elektronike si per industri, bujqesi, ndertim ashtu edhe per perdorim te lire publik;
- ngritjen dhe shfrytëzimin e restoranteve, bareve e kafeneve.

Selia do te jete ne Tirane, rruga "Budi",pall.58/2, ap. 13.

Afati i veprimtarise mbi 10 vjet.

Kapitali fillestar do te jete 100.000 (njqintemije) leke.

Kryetar i Asamblese se Ortakeve do te jete Z.Fatos VLLAMASI.

Administrator i Shoqerise emerohet Z. Bardhyl VLLAMASI.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankese ne Gjykate te Shkalles se dyte.

GJYQTARE

Majna Daku
Daku

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANË
Nr. 19098/1 VENDIMI

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Në Tiranë, sot më datë 03.03.2006, unë Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën dhe dokumentet e tjera të paraqitura nga kërkuesi z. *Fatos VLLAMASI* ;

K O N S T A T O V A

Më datën 24.03.1998, me vendimin Nr. 19098, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është regjistruar shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “**GERVIS**” shpk, me seli: - Rruga “Budi”, Tiranë.

Me vendimin Nr. 1, datë 22.02.2006, të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë “**GERVIS**” shpk, Tiranë, është vendosur si më poshtë :

1. *Bëhet largimi i ortakut, z. Bardhyl Vllamasi dhe mbetet ortak i vetëm z. Fatos Vllamasi.*
2. *Bëhet shitblerja e kapitalit brenda ortakërisë së shoqërisë:*
 - a- *Bardhyl Vllamasi i shet z. Fatos Vllamasi 50% të kapitalit të tij themeltar.*
 - b- *Fatos Vllamasi i blen z. Bardhyl Vllamasi shumën prej 50% të kapitalit dhe në këto ai ka shumën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë, ose baras me 100 000 lekë.*
3. *Administrator i Ri i shoqërisë do të jetë z. Fatos Vllamasi.*
4. *Ndryshime të tjera nuk ka.*
5. *Ngarkohet administratori të ndjekë në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tiranë, të depozitojë vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë.*

Kërkesa e tij është e drejtë, e bazuar në ligj e në Statut dhe duhet pranuar.

P Ë R K Ë T O A R S Y E

Në bazë të Ligjit Nr. 7638, dt. 19.11.1992, dhe Nr.7667 datë 28.01.1993

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës.

Depozitimim në Rregjistrin Tregtar të Vendimit Nr. 1, dt. 22.02.2006 të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë “**GERVIS**” SHPK, dhe i kontratës së shitblerjes së kuotave të kapitalit.

Urdhërimin e Zyrës së Rregjistrimit Tregtar të bëjë shënimet përkatëse në skedën e shoqërisë në kollonën .

GJYQTARE
[Signature]
Teuta HOXHA

1

2 a- "Gervit" leht

b. Li: "Gudi" p. 58/2 p. 13. Tõrre.

c- sätyp. murime te
kollektive olue. ni konstruktsione te
nivelle te uete...
ingrust ellusprovi.

d. 100 000 leue

Fotos villamati 50 000 leue

Dardhyll villamati 50 000 leue.

3. Adm: Dardhyll villamati akt. 19.

(N. 76) Li: Gudi p 58/2 p 13 Tõrre.

4.

10 y et

M - 3 flera

K - 11 flera

5.

19-12-97.

24-03-98

J. Kurbioneve

J. Kurbioneve M.H: 964384. Nr. 1109. 6445/362/00.

akt 20-03-98.



Ne mbështetje të Nenit 2, paragrafi 1, shkronja "ç", të ligjit Nr. 7512, date 10.08.1991, "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lire të veprimtarisë private të pavarur dhe të privatizimit", dhe të Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqëritë tregtare":

-- Fatos VLLAMASI, person fizik vendas, me banim në Tiranë, rruga "Budi", pall. 58/2, ap. 13;

dhe

-- Bardhyl VLLAMASI, person fizik vendas, me banim në Tiranë, rruga "Budi", pall.58/2, ap.13;

(me poshtë të quajtur "THEMELUES"), me date 18.12.1997 lidhen këto:

K O N T R A T E P E R T H E M E L I M I N E S H O Q E R I S E M E P E R G J E G J E S I T E K U F I Z U A R " G E R V I S "

Neni 1

Themeluesit e përmendur në preambulen e kësaj Kontrate, themelojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "GERVIS" (me poshtë e quajtur "Shoqëri").

Neni 2

Shoqëria ka për qëllim:

- të zgjerojë fushën e importit dhe eksportit me artikuj të ndryshëm;
- të zëre njëzë me punë;
- me anë të politikës së saj afariste të realizojë dhe të rrisë fitimet e Shoqërisë;

Neni 3

Shoqëria nga Neni 1 i kësaj Kontrate do të ushtrojë veprimtarinë e saj me emërtimin "GERVIS sh.p.k." Tiranë.

Neni 4

Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, rruga "Budi", pall. 58/2, ap.13.

Selia Administrative e Shoqërisë mund të vendoset gjetiu si dhe mund të suprimojë seli sekondare, filiale, zyra apo perfaqësi.

Neni 5

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- shrypshkrime të ndryshme;
- ndërtime dhe rikostruksione të niveleve të ulëta;
- import-export dhe shitje me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme industriale , blegtorale dhe ushqimore të të gjitha larmive;
- import-export dhe shitje me shumicë e pakicë të teknikës së bardhë dhe të zeze;
- importimin e pjesëve të këmbimit për automjete si dhe ngritjen e serviseve për automjete të vogla, të mëdha dhe makinerive bujqësore;

-- import dhe shitje me shumice e pakice te makinerive, paisjeve e veglave te punes per fusha te ndryshme teknologjike, si ne fushen e ndertimit, industrise, bujqesise, hotelerise,

otij;
-- import dhe shitje me shumice e pakice te makinerive e paisjeve elektrike dhe elektronike si per industri, bujqesi, ndertim ashtu edhe per perdorim te lire publik;

-- ngritjen dhe shfrytëzimin e restoranteve, bareve e kafeneve,

Neni 6

Veprimtaria e Shoqerise, emertimi dhe selia e saj te percaktuara ne kete Kontrate, nuk mund te ndryshojne pa pelqimin e paleve kontraktues, perkatesisht Themeluesve..

Neni 7

Shoqeria ka statusin e Personit Juridik.

Neni 8

Shoqeria i ka te gjitha te drejtat ne veprimtarine juridike me personat e trete.

Neni 9

Themeluesit i sigurojne mjetet per themelimin dhe fillimin e punes se Shoqerise ne shumen prej 100,000.00 (njqintemije) leke, i ndare ne kuota prej 10,000.00 (dhjetemije) leke secila. Kontributi i kapitalit themelues te Shoqerise eshte i perbere ne para te gateshme.

Neni 10

Themeluesit rane dakort qe pjesemarrja e tyre ne kapitalin themelues te Shoqerise te jete si vijon:

- Fatos VLLAMASI - 5 kuota e barabarte me 50.000 leke;
- Bardhyl VLLAMASI - 5 kuota e barabarte me 50.000 leke;

Neni 11

Mjetet nga Neni 10 i kesaj Kontrate, Themeluesit do ti depozitojne ne njerën nga Bankat e ndodhura ne qytetin e Tiranes ku do te celet xhirrollogaria e shoqerise.

Pasi te veprojne ne perputhje me paragrafin e pare te ketij neni, Themeluesit kane te drejte qe te kerkojne vertetimin per mjetet e investuara, perkatesisht per kryerjen e pageses me para te gateshme, konform Nenit 40 dhe 41 te Ligjit "Per shoqerite tregtare".

Neni 12

Themeluesit mbajne te drejten e pronesise ne mjetet e investuara ne Shoqeri.

Neni 13

Neqoftese Shoqeria nuk ka mundesi ti perballoje detyrimet e saj kreditore, per keto detyrime Themeluesit nuk pergjigjen.

Neni 14

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

- Asamblea e Ortakeve;
- Administratori;
- Komisioni i Revizionit.

Neni 15

Asamblea e Ortakeve eshte organi me i larte i Shoqerise.

Neni 16

Cdo ortak i Shoqerise eshte anetar i Asamblese se Ortakeve.



Ceshtjet e tjera nga veprimtaria e Asamblese se Ortakeve rregullohen hollesisht ne Statutin e Shoqerise.

Neni 17

SHOQERIA do te administrohet nga nje Administratore.
Kohezgjatja ne detyre e Administratorit eshte deri ne revokim ose doreheqje ose caktohet nga Asamblea.
Administratori dhe kohezgjatja e tij caktohen ne Statutin e Shoqerise.

Neni 18

Komisioni i Revizionit perbehet nga 2 anetare te cilet zgjidhen nga vete Ortaket.

Neni 19

Themeluesit e Shoqerise disponojne mbi fitimin qe realizon Shoqeria gjate ushtrimit te veprimtarise se saj.
Fitimi percaktohet me bilancin vjetor te Shoqerise.

Neni 20

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj te percaktuar ne kete Kontrate per nje periudhe te pacaktuar, por jo me pak se 10 vjet.

Neni 21

Shoqeria mund te bashkohet me persona te tjere juridike, te shkrihet ne subjekt tjetër juridik dhe te ndahet ne dy apo me shume subjekte juridike vetem me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

Neni 22

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin ne Gjykatën e rrethit te Tiranes.

Neni 23

Cdo shtese apo ndryshim Kontrates do te behet me shkrim dhe me aprovimin e Asamblese se Ortakeve.

Neni 24

C'do mosmarveshje qe nuk mund te zgjidhet me bisedime ndermjet Themeluesve, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Tirane sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 25

Shpenzimet e ketij akti, nese do te kete, jane ne ngarkim te Shoqerise se sapo krijuar.

Neni 26

Kjo Kontrate hyn ne fuqi dite e nxjerrjes dhe te nenshkrimit nga Themeluesit.

THEMELUESIT

Fatos VLLAMASI



Bardhyl VLLAMASI



Ne mbështetje të Nenit 2, paragrafi 1, shkronja "ç", të ligjit Nr.7512, datë 10.08.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarisë private të pavarur dhe të privatizimit", të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" si dhe të Nenit 16 të Kontrates për Krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "GERVIS" :

-- Fatos VLLAMASI, person fizik vendas, me banim në Tiranë, rruga "Budi", pall. 58/2, ap. 13;

dhe

-- Bardhyl VLLAMASI, person fizik vendas, me banim në Tiranë, rruga "Budi", pall.58/2, ap.13;

(me poshtë të quajtur "THEMELUES"), me datë 18.12.1996 nxorren këtë:

**STATUT
TE SHOQERISE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" GERVIS "**

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Themeluesit e përmendur në preambulen e këtij Statuti, themelojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "GERVIS" (me poshtë e quajtur "Shoqëri") në Tiranë, me këtë Statut, në përputhje me Kontraten për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe me legjislacionin shqiptar. Ky Statut rregullon pozitën juridike të bashkëthemeluesve dhe të punonjësve të Shoqërisë, të dhenat me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e Shoqërisë.

Neni 2

Shoqëria është krijuar me Kontraten për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "GERVIS" me mjetet vetjake të Themeluesve.

Neni 3

Shoqëria nga Neni 1 i këtij Statuti do të ushtrojë veprimtarinë e saj me emërtimin " GERVIS sh.p.k." Tiranë.

Neni 4


Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, rruga "Budi" pall.58/2, ap.13.

Neni 5

Shoqëria ka statusin e Personit Juridik dhe ushtron veprimtarinë e saj ekonomike të përcaktuar në këtë Statut për të realizuar fitimin.

Neni 6

Shoqëria ka vullen e saj.



Vula ka forme te rumbullaket, madhesi te zakonshme, rreth e perqark se ciles eshte shkruar teksti: " *Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar* Tirane ALBANIA*" dhe ne mes te se ciles eshte vendosur emrtimi i Shoqerise "GERVIS".

Neni 7

Vula perdoret ne menyren dhe proceduren te cilat i percakton me shkrim Administratori i Shoqerise.

Neni 8

Shoqeria ka intestimin e saj.

Intestimi ka forme te katerkendeshit kendedrejte, me madhesi A4, ne skajin e siperm te te cilit eshte shkruar teksti: " GERVIS sh.p.k." dhe sigla e Shoqerise. Ndene kete tekst ndare me nje vize te holle eshte shenuar ne te majte "Nr. _____ prot." dhe ne te djathte " Tiarne, me _____.199_".

II. OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 9

Shoqeria ka per qellim:

- te zgjeroje fushen e importit dhe exportit me artikuj te ndryshem;
- te zere njez me pune;
- me ane te politikës se saj afariste te realizoje dhe te rrise fitimet e Shoqerise.

Neni 10

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj:

- shrypshkrime te ndryshme;
- ndertime dhe rikostruksione te niveleve te uleta;
- import-export dhe shitje me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale , blegtorale dhe ushqimore te te gjitha larmive;
- import-export dhe shitje me shumice e pakice te teknikes se bardhe dhe te zeze;
- importimin e pjeseve te kembimit per automjete si dhe ngritjen e serviseve per automjete te vogla, te medha dhe makinerive bujqesore;
- import dhe shitje me shumice e pakice te makinerive, paisjeve e veglave te punes per fusha te ndryshme teknologjike, si ne fushen e ndertimit, industrise, bujqesise, hotelerise, etj;
- import dhe shitje me shumice e pakice te makinerive e paisjeve elektrike dhe elektronike si per industri, bujqesi, ndertim ashtu edhe per perdorim te lire publik;
- ngritjen dhe shfitytezimin e restoranteve, bareve e kafeneve,

Neni 11

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj te percaktuar ne kete Statut ne territorin e Republikës se Shqiperise.

Per kryerjen e kesaj veprimtarie, Shoqeria mund te cele Deget dhe Zyrat e saj te perfaqesimit ne Shqiperi ose jashte ne perputhje me legjislacionin shqiptar.


Neni 12

Veprimtaria e Shoqerise, emertimi dhe selia e saj te percaktuara ne kete Statut nuk mund te ndryshojne pa pelqimin e Themeluesve.

Neni 13

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

Shoqeria i ka te gjitha te drejtat ne veprimtarine juridike me te tretet.



Neni 14

Per detyrimet e veta Shoqeria pergjegjet me tere pasurine e saj.
Themeluesit nuk pergjegjen per detyrimet e Shoqerise.

Neni 15

Themeluesit bartin rrezikun per veprimtarine e Shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve (kuotes) te dhena me rastin e krijimit te saj.

III. MJETET E SHOQERISE

Neni 16

Themeluesit i sigurojne mjetet per themelimin dhe fillimin e punes se Shoqerise ne shumen prej 100,000.00 (njqintemije) leke, te ndara ne 10 kuota prej 10,000 leke secila dhe te nenshkruara te gjitha me emer.

Themeluesit rane dakort qe pjesemarrja e tyre ne kapitalin themelues te Shoqerise te jete si vijon:

- Fatos VLLAMASI, si ortak perfaqeson kapitalin me 5 kuota te kapitalit themelues, perkatesisht prej 50.000 (pesedhjetemije) leke;
- Bardhyl VLLAMASI, si ortak perfaqeson kapitalin me 5 kuota te kapitalit themelues, perkatesisht prej 50.000 (pesedhjetemije) leke;

Neni 17

Mjetet nga Neni 16 i ketij Stauti evidentohen ne Librat Afariste te Shoqerise.

Neni 18

Pervec rastit te transferimit me titull trashegimie ne raste vdekje, transferimi i kuotave midis te gjalleve (perfshire edhe rastin e lenies menjane te trashegimtareve te nje ortaku te vdekur),kur nuk i eshte bere njerit ose me shume Ortakeve fillestare,kerkon aprovimin paraprak te Asamblese se Ortakeve.

Transferimi i kuotave (pjeseve te kapitalit) disiplinohet konform Neneve 46 dhe 47 te Ligjit "Per shoqerite tregtare".

Neni 19

Shoqeria mund te plotesoje mjete plotesuese me rregjistrimin e pjeseve (kuotave) te reja te kapitalit nga te tjeret qe i aderojne Shoqerise po qe se me propozim te Administratorit , me kete pajtohen Themeluesit.

Themeluesi i ri rregjistron pjesen (kuoten) e tij te kapitalit ne menyren qe e percakton Administratori i Shoqerise.

Neni 20

Cdo kuote jep te drejten per nje vot.

IV. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 21

Shoqeria zhvillon veprimtarine e vet te percaktuar ne kete statut, ne perputhje me Kontraten per krijimin e Shoqerise, me legjislacionin shqiptar dhe me Statutin e saj.

Neni 22

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me mjetet e investuara ne fondet e saj, me kredite e akorduara dhe me mjetet e tjera.



Shoqeria eshte e detyruar qe vellimin e punes se vete ta ushtroje veresisht nga shuma e mjeteve te investuara ne fondin themelor te Shoqerise dhe nga shuma e mjeteve te rezerves.

Neni 23

Shoqeria cakton fondet e meposhteme:

- 1- Fondin themelor;
- 2- Fondin rezerve, te ndare ne :
 - a) rezerva legale;
 - b) rezerva e zakonshme;
 - c) rezerva per luhatjet valutore;
 - d) rezerva operative.

Per ushtimin e veprimtarise se vet, Shoqeria mund te caktojte edhe fonde te tjera. Keto fonde percaktohen ne mbledhjen e zakonshme te Asamblese se Ortakeve.

Neni 24

Fondi themelor i Shoqerise formohet nga mjetet e investuara te Themeluesve dhe nga mjetet ne para te investuara nga persona te tjere.

Neni 25

Shoqeria shfrytezon fondin themelor per ushtimin e veprimtarise se saj, per investime ne fondet e lokaleve, shoqerive dhe organizatave te tjera qe i ka formuar ajo si dhe per te mbuluar rreziqet pas shfrytezimit te mjeteve te rezerves.

Fondin themelor, Shoqeria mund ta shfrytezoje edhe per destinacione te tjera, ne perputhje me aktet e politikese se saj afariste.

Neni 26

Fondi rezerve i Shoqerise formohet nga nje pjese e fitimit qe Shoqeria realizon gjate veprimtarise se saj, qe percaktohet me nje vendim te vecante te Themeluesve.

Mjetet e fondit rezerve jane mjetet vetiakte te Shoqerise dhe shfrytezohen per te mbuluar humbjet dhe rreziqet.

Fondi rezerve mund te perdoret edhe per destinime te tjera ne perputhje me aktet e politikese sa saj afariste.

Neni 27

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe raportit financiar vjetor nga Asambleja e Ortakeve (Themeluesve), pjesa e fitimit neto qe u perket Themeluesve mund te transferohet lirisht jashte shtetit Shqiptar pa asnje kufizim.

V. ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 28

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve;
- Administratori;
- Komisioni i Revizionit.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 29

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte dhe vendimor i Shoqerise.



Neni 30

Cdo Ortak eshte anetar i Asamblese dhe merr pjese ne votim ne baze te kuotave qe disponon.

Neni 31

Asamblea e Pergjithshme e zakonshme thiret cdo vit, te henen e dyte te dhjetorit ne ora 10:00.

Ne rast se ajo bie dite pushimi, Asamblea e Pergjithshme mblidhet te paren dite pune vijuese, ne te njejten ore.

Pavec kesaj, Ortaket mblidhen ne Asamble te Pergjithshme speciale (jashtezakonshme) sa here qe interesat e Shoqerise e kerkojne; Administratori eshte i detyruar ta therasse brenda muajit qe ka marre kerkesen e Ortakeve qe perfaqesojne nje te dhjeten (10%) e kapitalit.

Asamblete e Pergjithshme te zakonshme ose te jashtezakonshme mbahen ne seline sociale te Shoqerise ose ne vendin e caktuar ne lajmerim.

Lajmerimi duhet te permbaje rendin e dites.

Neni 32

Asamblea e Ortakeve do te mbaje mbledhjen e pare te saj jo me vone se 30 dite nga data e regjistrimit te Shoqerise.

Neni 33

Asamblea e Ortakeve ushtron keto pune:

- propozon dhe miraton numrin e administratoreve dhe emerone Administratoret e shoqerise;
- nxjerr planin dhe programin e zhvillimit dhe aktet e pergjithshme, vendimin per ndryshimin e mertimit, selise dhe veprimtarise se Shoqerise;
- vendos per rritjen ose pakesimin e kapitalit themelor te Shoqerise;
- jep udhezime dhe synime te nevojshme dhe orienton punen e Administratoreve te Shoqerise;
- miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar vjetor te Shoqerise;
- nxjerr Statutin e Shoqerise dhe percakton bazat e politikes afariste;
- vendos per ndarrjen dhe perdorimin e fitimit dhe per mbulimin e humbjeve e te rreziqeve;
- vendos per ndryshimin e formes se organizimit te Shoqerise;
- miraton propozimin e Administratoreve per krijimin e nje Shoqerie te re me pjesemarrjen e saj si Ortak;
- vendos per pushimin (mbylljen) e Shoqerise;
- emerone dhe shkarkon anetaret e Komisionit te Revizionit;
- nxjerr regulloren per punen e Asamblese se Ortakeve;
- drejton punet e tjera te rendesishme per afarizmin e Shoqerise.

Neni 34

Asamblea e Ortakeve mund te punoje dhe per ceshtjet nga veprimtaria e saj mund te vendose ne menyre meritore nese ne mbledhje te Asamblese eshte e pranishme 60 % e kuotave te kapitalit themeleues.

Neni 35

Asamblea e Ortakeve punon dhe vendos ne mbledhje.

Neni 36

Cdo pronare kuotash (Ortak) mund te perfaqesohet ne asamble nga nje i deleguar.

Administratori mund te caktojne formulen e prokures dhe te kerkojne qe ajo te depozitohet ne vendin e caktuar prej tij, per dite te plota perpara Asamblese se pergjithshme.



Neni 37

Te gjitha Asamblete e Pergjithshme kryhesohen nga Kryetari i Asamblese ose Administratori, ose ne mungese te tyre nga Ortaku me i moshuar.
Ne raste kur votimi eshte i barabarte, vota e Kryetarit te Asamblese eshte vendimtare.
Kryetari cakton sekretarin.

Neni 38

Asnje votim nuk mund te behet per nje ceshtje qe nuk figuron ne rendin e dites, pervec kur te gjitha Ortaket jane te pranishem dhe shprehin pelqimin e tyre, ose ne rast se te gjitha Ortaket jane te perfaqesuar dhe prokurat e lejojne.
Pervec rasteve te parashikuara me ligj, vendimet merren pavaresisht numrit te kuotave te perfaqesuar ne asamble, me shumicen e votave.
Lista e pjesmarrsve ku shenohet emri i Ortakut dhe numri i kuotave, nenshkruhet prej tyre ose prej te deleguarve perpara hyrjes ne seance.

Neni 39

Proces verbalet e Asamblese se pergjithshme nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese se Ortakeve, Administratori, Sekretari dhe ortaket qe e kerkojne.
Kopje ose pjese te proces-verbaleve per ti paraqitur ne organet e drejtesise ose ne vende te tjera, nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese ose nga Administratori.

ADMINISTRATORI**Neni 40**

Shoqeria administrohet nga nje Administratore, pjestare ose jo, i emeruar te pakten per 1 vit, nga Asamblea e pergjithshme e Ortakeve dhe te revokueshem prej saj.
Ai mund te rizgjidhet.
Mandati i administratorit pushon menjehere pas asamblese se pergjithshme qe ka bere rizgjedhjen.

Neni 41

Administratori eshte i veshur me pushtetin me te gjere per te kryer cdo akt qe eshte i nevojshem ose i dobishem per plotesimin e objektivave sociale, me perjashtim te atyre qe me ligj i rezervohen Asamblese se pergjithshme te Ortakeve.
Pa demtuar ai mundet:
a) delegime speciale te leshuara nga Administratori njerit prej Ortakeve;
b) delegime te leshuara konform Nenit 42 per ceshtje te administrimit te perditshem;
c) per cdo mandat special leshuar nga administratori cdo personi qe nuk eshte nepunes i Shoqerise.

Neni 42

Administratori mund te delegoje administrimin e perditshem te puneve te Shoqerise si dhe riperfaqesimin per kete administrim, nje ose me teper drejtoreve ose agjenteve te tjere, te cilet veprojne vetem ose bashkerisht.
Ne rast delegimi, Administratori cakton pushtetet dhe shperblimet speciale per keto funksione.

Neni 43

Shoqeria gjithashtu mund te perfaqesohet ne menyre te vlefshme perpara drejtesise nga Administratori.
Ne rastet kur eshte vene ne perdorim nje mandat ose delegim, organizuar sipas Nenit 42, nenshkrimi i delegatit ose te deleguarit per ndjekjet gjyqsore ose kerkesat e bera prej tyre angazhojne Shoqerine, brenda kufijve te pushteteve qe i jane dhene.



Neni 44

Me rastin e cdo emerimi, Asamblea e pergjithshme vendos neqoftese mandati i administratorit do te shperblehet me nje shume fikse ose e ndryshueshme ne ngarkim te shpenzimeve te pergjithshme.

KOMISIONI I REVIZIONIT

Neni 45

Shoqeria ka Komisionin e Revizionit, perkatesisht Ekspertet Kontabel. Komisioni i Revizionit perbehet nga 2 (dy) anetare, te cilet zgjidhen nga Themeluesit. Kryetari dhe Anetaret zgjidhen per nje periudhe prej 3 (tre) vjetesh vjet por me te drejte qe te mund te rizgjidhen por gjithmone ne pajtueshmeri me Nenet 168 dhe 169 te Ligjit "per shoqerite tregtare".

Neni 46

Komisioni i Revizionit kontrollon veprimtarine e Shoqerise, te degeve dhe te perfaqesive te saj, sidomos ate financiare.

Neni 47

Kryetari dhe Anetaret e Komisionit te Revizionit ne kryerjen e detyrave jane te pavarur.

Neni 48

Komisioni i Revizionit eshte pergjegjes per veprimtarine e tij perpara Asamblese se Ortakeve dhe eshte i detyruar ti paraqese asaj cdo vit raportin dhe kontrollet e bera, si dhe konkluzionet per bilancet vjetore.

VI. MENYRA DHE KUSHTET E NDARAJES SE FITIMIT, BARTJA E RREZIKUT DHE HUMBJET

Neni 49

Pas likuidimit te taksave, tatimeve, ndarjes se mjeteve per pagat e punes te punonjesve te Shoqerise, mbetet ne dispozicion fitimi neto. Per shperndarjen e fitimit neto vendosin ortaket ne Asamblene e tyre ne fund te vitit financiar.

Neni 50

Fitimin e realizuar, Themeluesit e ndajne ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themelor te Shoqerise, te parashikuar ne Nenin 16 te ketij Stauti. Punonjesit nuk marrin pjese ne shperndarjen e fitimit po qe se me kontraten e punes nuk rregullohet ndryshe.

Neni 51

Fitimi neto i Shoqerise ndahet:

- ne pjesen per ortaket e Shoqerise;
- ne pjesen per zgjerimin e bazes materiale te punes, per zhvillimin e metejshem te saj;
- ne pjesen qe i shperndahet punonjsve, ne se me kontraten e punes eshte parapare qe ata te marrin pjese ne shperndarjen e fitimit te Shoqerise.

Vendimin per ndarjen e fitimit ne menyren e percaktuar ne paragrafin e pare te ketij neni e nxjerrin Themeluesit.

Dividentet e pa terhequra brenda 3 vjeteve nga momenti kur ato jane bere te terheqeshme, shkojne ne favor te Shoqerise duke u transferuar ne nje fond te posacem rezerve.

Neni 52



Themeluesit bartin rrezikun per humbjet eventuale ne veprimtarine e Shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve (kuotes) se investuar me rastin e krijimit te saj.

Neni 53

Humbja mbulohet nga e tere pasuria e Shoqerise.

Neni 54

Nese Themeluesit nje here i kane mbuluar humbjet e Shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve (kuotes) se investuar me rastin e krijimit te saj, nuk jane te detyruar te bartin rrezikun per humbjet e metejme.

Neni 55

Neqoftese ne bilancin vjetor, Shoqeria nuk del me fitim por me humbje, atehere humbjet do te mbulohen ne perputhje me Nenin 52 te ketij Satuti.

Neni 56

Nese mbas mbulimit te humbjeve ne menyren e parashikuar ne Nenin 52 te ketij Stauti, teprojne disa mjete, shuma e tyre qe paraqet sigurine e kuotes themeluese, nuk mund te shfrytëzohet per shperndarje ne perputhje me Nenin 51 te ketij Stauti.

Neni 57

Nese humbjet jane krijuar me fajin eskuziv te njerit prej Themeluesve, atehere ai Themelues eshte i detyruar ti mbuloje ato me mjetet e veta.

Neni 58

Neqoftese humbjet e Shoqerise nuk mund te mbulohen me mjetet e Themeluesve, te dhena me rastin e krijimit te Shoqerise, ne perputhje me Nenin 54 te ketij Satuti, ndaj Shoqerise hapet procedura e likuidimit, perkatesisht falimentit.

VII. ORGANIZIMI I BRENDESEM I SHOQERISE

Neni 59

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me anen e njesive organizative te saj. Punonjesit ne Shoqeri varesisht nga lloji dhe natyra e punes qe bejne caktohen neper njesite organizative te saj.

Njesite organizative jane sektoret.

Keta dhe veprimtaria e tyre caktohen me vendim te Administratorit.

Neni 60

Sektoret nuk kane status te Personit Juridik, as autorizime ne qarkullimin juridik me te trete.

Neni 61

Ne sektor udheheq pergjegjesi (shefi) i sektorit.

Pergjegjesin (shefin) e sektorit e emeron dhe e shkarkon Administratori, me mendimin paraprak te Themeluesve.

Per punen e tij pergjegjesi (shefi) i sektorit, pergjigjet para Administratorit.

VIII. MARREDHENIET E PUNES

Neni 62

Marredheniet e punes ne Shoqeri rregullohen ne perputhje me Kontraten per krijimin e Shoqerise, legjislacionin shqiptar dhe kete Statut.



Neni 63

Ne kontraten e punes, ne perputhje me legjislacionin e punes dhe me kontraten e punes kolektive, rregullohen keto ceshtje:

- kushtet dhe menyra e themelimit te marredhenies se punes;
- fillimi i punes se punonjesit dhe caktimi i tij ne vendin e punes;
- koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte orarit te punes, puna ne diten e pushimit javor dhe te festes zyrtare;
- pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes;
- nderprerja e marredhenies se punes.

Neni 64

Punonjesit ne Shoqeri per punen e tyre marrin pagen varesisht nga rezultatet e arritura ne pune ne perputhje me kontraten e punes.

Ne kontraten e punes caktohet paga e punes se punonjesit, shperblimi i pages dhe shperblimet e tjera.

IX.PERGJEGJESIA E PUNONJESVE**Neni 65**

Punonjesi eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e punimeve dhe zbatimeve e detyrave ne menyre te ligjeshme dhe profesionale.

Neni 66

Administratori dhe Shefat e Sektoreve jane pergjegjes per kryerjen e puneve nga kompetenca e tyre.

Administratori, Shefi sektorit dhe punonjesit e tjere udheheqes bartin dhe pergjegjesine materiale per marrjen e vendimeve joligjore dhe te vendimeve me te cilat demtohet materialisht Shoqeria dhe Themeluesit e saj, varesisht nga ndikimi i tyre per marrjen dhe zbatimin e vendimeve te tilla.

X. SEKRETI I PUNES**Neni 67**

Sekret te punes paraqesin shkresat, materialet, perkatesisht aktet, te cilat me ligj dhe dispozita te tjera, si dhe me vendimet e nxjerra nga organet e Shoqerise jane te shpallura si sekrete te punes.

Neni 68

Sekretin e punes jane te detyruar ta ruajne te gjithe punonjesit e shoqerise.

Neni 69

Detyra e ruajtjes se sekretit te punes vazhdon edhe pas nderprerjes se marredhenieve te punes ne shoqeri.

Neni 70

Te dhenat qe paraqesin sekret te punes mund ti kumtohen personave te tjere vetem me lejen e Administratorit te Shoqerise.

XI. KOHEZGJATJA E SHOQERISE**Neni 71**

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj te percaktuar ne kete Kontrate per nje periudhe te pacaktuar, por jo me te vogel se 10 vjet.



XII. MBYLLJA E SHOQERISE

Neni 72

Shoqeria mund te shperndahet ne cdo kohe me vendim te Asamblese se pergjithshme e mbledhur ne forme dhe kushtet e kerkuara per ndryshime ne Statut.

I. Ne rast se si pasoje e humbjeve,aktivi neto reduktohet ne nje shume me te vogel se gjysma e kapitalit social, asamblea e pergjithshme duhet te mblidhet e shumta brenda dy muajve duke filluar nga casti kur eshte konstatuar humbja ose duhej te ish konstatuar ne perputhje me detyrimet legale ose statute, me qellim qe ajo te vendose ne formen e parashikuar per ndryshime ne Staut mbi shperndarjen eventuale te Shoqerise ose per masa te tjera te njoftuara ne rendin e dites.

Administratori do ti justifikoje propozimet e tij ne nje raport special i vene ne dispozicion te Ortakeve pesembedhjet dite perpara asamblese se pergjithshme.

II. Kur aktivi neto reduktohet ne nje shume me te vogel se nje e katerta e kapitalit social, shperndarja mund te vendoset nga nje e katerta e votave te dhena ne asamble.

III. Ne rast se aktivi neto reduktohet ne nje shume me te vogel se kapitali minimum legal,cdo person i interesuar mund ti kerkoje Gjykates shperndarjen e Shoqerise.

Neni 73

Grumbullimi i te gjitha kuotave (kuotave) ne duart e nje Ortaku te vetem nuk sjell as shperndarjen me te drejte as shperndarjen gjyqsore te Shoqerise.

Ne rast se brenda nje viti, Shoqeria nuk eshte shperndare ose perforcuar me ardhjen e nje Ortaku te ri, Ortaku i vetem eshte i quajtur garant solidar per te gjitha angazhimet e Shoqerise te kontraktuara qysh prej grumbullimit te te gjitha kuotave.

Neni 74

Ne rast te shperndarjes se Shoqerise per dicka dhe ne cdo moment qe te jete, likuidimi kryhet me ane te likuidatoreve, te emeruar nga asamblea e pergjithshme dhe ne mungese te nje emerimi te tille, likuidimi kryhet nga Administratori ne funksion.

Likuidoret ose Administratori disponojne per kete qellim,pushtetet me te gjera qe i jepen nga Nenet 276 e vijues te Ligjit "Per shoqerite tregtare".

Asamblea e pergjithshme vendos shperblimin eventual te likuidatoreve.

XIII. VITI FINANCIAR

Neni 75

Viti i pare financiar social fillon me 15.02.1996 (nentedhjetegjashte) dhe mbyllet me 15.02.1997 (nentedhjeteshtate).

Veprimtaria e Shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti.

XIV. DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 76

Ortaket zgjedhin ne organet e para te Shoqerise si me poshte:

1. Kryetar te Asamblese se Ortakeve, Zotin Fatos VLLAMASI, me mandat 1 vjet.
2. Administratore te Shoqerise, Zotin Bardhyl VLLAMASI , me mandat 1 vjet.

Neni 77

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin ne Gjykatën e rrethit te Tiranës.

Neni 78

Cdo shtese apo ndryshimi i Stautit do te behet me shkrim dhe me aprovimin e Asamblese se Ortakeve.



Neni 79

Propozimin per ndryshimet dhe plotesimet e Stautit mund ti jape secili prej Themeluesve te Shoqerise.

Propozimi nga paragrafi i pare i ketij Neni jepet me shkrim.

Neni 80

Cdo mosmarreveshje qe nuk mund te zgjidhet me bisedime ndermjet Themeluesve, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Tirane sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 81


Te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, duhet referuar ne Ligjin "Per shoqerite tregtare".

Neni 82

Ky Statut hyn ne fuqi dite e nxjerrjes dhe te nenshkrimt nga Themeluesit.

THEMELUSIT

Fatos VLLAMASI



Bardhyl VLLAMASI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE

Nr. 4297 Rep. Nr. Kol.

VERTETIM

Sot, me date 19 dhjetor 1997 (nëntëdhjeteshtate) u paraqiten pare meje, noterit z. Fatos Vllamasi dhe z. Bardhyl Vllamasi, madhore, me notesi te plote juri ike per te vepruar, te cilet kete statut e kane hartuar me vullnet te lire jashte kesaj syre dhe e nenshkruan para meje ndersa une noteri e vertetoj ate ne teze te ligjit.

LULEZIM FORTUZI
NOTER
TIRANE-ALBANIA
Tel: 355 42 264 98



NR. 964384

SERIA A.05

VALUTA

LEKE

MANDATAHKETIMI
(I BRENDSHEM)

DEPTESE ARKETIMI 2

DISTINA

KOMISIONE BANKARE

AR-KETUAR GJITHSEJ

COPE

PRERJE

SHUMA

100,000

500

100,500

00

00

00

njegindmi) e pësejind

98 x 1000

4 x 500

1 x 100

3 x 100

KIE URONDER

LEKE

NE KRED

VILLAMASI

NUMRI I LLOGARISE

0445/3622/00

REF

SHUMON KAPITAL FILLËSTAR

SHUMA

100 500

METALIKE

GJITHSEJ

VENDI

DATA

UNDHERSHKIMET (PUNËSIME)

DHE NENSHKRIMET E BANKES

ARKETARI

BANKA E KURSIMEVE
SPORTELIS TIRANE

20. März 1998

312/100

Që qet, fitoj me vlerë dhe dokumentet e ngjashme për kredite në llogarë të hapura nga Banka e Kursimeve në rezervë për verifikim. Kur ato kthehen pa paguar, Banka debitorin me iniciativë llogarë e perfuturës. Në rast mundësie të gjatë në llogari, perfuturës detytohet të kthejë menjëherë Bankes shumën përkatëse. Kur drejtë kërkesas së drejtë të te sakt.

K E R K E S E

KERKUESI :

"GERVIS" sh.p.k. me themelues Fatos VLLAMASI
neneshtetas shqiptar dhe Bardhyl VLLAMASI
neneshtetas shqiptar,

OBJEKTI :

Rregjistrim si Person Juridik, per te fituar zotesine
per te vepruar ne baze te nenit 5 te ligjit 7512
date 10.08.1991.

PERPARA :

GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE

I nderuar Zoti Kryetar,

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "GERVIS", me themelues Fatos VLLAMASI, banues ne Tirane, rruga "Budi", pall.58/2, ap.13 dhe Bardhyl VLLAMASI, banues ne Tirane, rruga "Budi", pall.58/2, ap. 13, desherojne te kryeje veprimtari private ne Republiken e Shqiperise me kete objekt:

- shrypshkrime te ndryshme;
- ndertime dhe rikostruksione te niveleve te uleta;
- import-export dhe shitje me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale , blegtorale dhe ushqimore te te gjitha larmive;
- import-export dhe shitje me shumice e pakice te teknikes se bardhe dhe te zeze;
- importimin e pjeseve te kembimit per automjete si dhe ngritjen e serviseve per automjete te vogla, te medha dhe makinerive bujqesore;
- import dhe shitje me shumice e pakice te makinerive, paisjeve e veglave te punes per fusha te ndryshme teknologjike, si ne fushen e ndertimit, industrise, bujqesise, hotelerise, etj;
- import dhe shitje me shumice e pakice te makinerive e paisjeve elektrike dhe elektronike si per industri, bujqesi, ndertim ashtu edhe per perdorim te lire publik;
- ngritjen dhe shfrytezimin e restoranteve, bareve e kafeneve,

Selia do te jete ne Tirane, rruga "Budi", pall.58/2, ap.13.

Kapitali fillestar themelues do te jete 100.000,00 (njqintenjetetemije) leke.

Kryetar i Asmablese se Ortakeve do te jete Z. Fatos VLLAMASI.

Administratore i Shoqerise emerohet Zoti Bardhyl VLLAMASI.

Per arsyet e mesiperme, ne baze te nenit 5 te ligjit 7512, date 10.08.1991



KERKOJME

Rregjistrimin ne Gjykatën e Rrethit Tirane te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "GERVIS" Tirane, si Person Juridik per te fituar zotesine per te vepruar.

KERKUESIT

Fatos VLLAMASI



Bardhyl VLLAMASI



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

Nr. 4296 Rep. Nr. Kol.

V E R T E T I M

Sot, ne dite 19 dhjetor 1997 (nenteshteteshtate) u paraqiten para meje, noterit, kerkuesit Fatos Vllamasi dhe s. Bardhyl Vllamasi bashker, ne zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentet e tyre identifikuese, te cilet keto kerkese e kane hartuar ne vullnet te lire dhe e nenshkruan para meje, noterit, ndersa une e vertetoj ate ne baze te ligjit.

LULEZIM FORTUZI
NOTER
TIRANE-ALBANIA
Tel 355 42 264 98



19098/1

Z. V. Hoxha
23.02.2006
23 SHKURT 2006

KERKESE

KERKUSI.

FATOS VLLAMASI i biri i Fahriut i datelindjes 25.08.1954 me banim ne Tirane me cilesin e Administratori dhe ortakut te vetem shpk "GERVIS" me shtetesi dhe kombesi Shqiptare ..

Te" Depozitohet vendimi

OBJEKTI DHE BAZA LIGJORE

Nr 1004 - 22-02-2006

Depozitim vendimi Nr 1 date 22.02.2006 te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "GERVIS" shpk, Tirane ne baze te ligjit me nr 7638 te dates 19.11.1992 dhe nr 7667 te dates 28.01.1993..

1. Komiteti i kufizuar nr 657

Rez du 158 uol datu 22-02-2006

Shoqerise "GERVIS" shpk

GJYKATES SE RRETHIT GJYQSOR

TIRANE

Me daten 24.03.1998 me Vendimin NR 19098 te Gjykeses se Enkalles se Pare Tirane eshte Rregjistruar Person Juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "GERVIS" shpk, me adrese ne rrugen "Budi" Tirane . Me vendimin Nr 1 date 22.02.2006 te mbledhjes se Asamblese se ortakëve te Shoqerise "GERVIS" shpk Tirane eshte bere ndryshim si me poshte ;

- 1- Behet largimi i ortakut , z. Bardhyl VLLAMASI dhe mbetet ortak i vetem z. Fatos VLLAMASI.
- 2 - Behet shitblerja e kapitalit brenda ortakërisë së shoqerisë ;
 - a- Bardhyl VLLAMASI i shet z. Fatos VLLAMASI 50% te kapitalit te tij themeltar .
 - b- Fatos VLLAMASI i blen z. Bardhyl VLLAMASI shumen prej 50 % te kapitalit dhe ne keto ai ka shumen 100 % te kapitalit themelare te shoqerise ose baras me 100 000 leke.
- 3 - ADMINISTRATORI I RI I shoqerise do te jete z. FATOS VLLAMASI
- 4 - Ndryshime te tjera nuk ka .
- 5- Ngarkohet Administratori te ndjek ne gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tirane te depozitohet vendimin e asamblese se ortakëve te shoqerise . Bashkangjitur eshte vendimi i asamblese se ortakëve dhe kontrata e shitblerjes se kapitalit te shoqerise "GERVIS" SHPK Tirane
- 6- Bashkangjitur eshte kontrata e shitblerjes se kuotave .

KERKUSI
ADMINISTRATOR
I SHOQERISE "GERVIS" SHPK

Fatos Vllamasi
[Signature]






REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 655 REP
Nr Kol

VERTETIM

Ne , Tirane sot me date 22.02.2006 ne zyren e noterise u paraqite personalisht 1-z.FATOS VLLAMASI i biri i Fahriut i *datelindjes* 25.08.1954 me nr QH331120 te dokumentit te identitetit tetije personal me banim ne Tirane me cilesin e Administratori dhe ortakut te vetem shpk " GERVIS " ka zotesi te plote juridike per te vepruar eshte madhor me deklaroj se ne mbledhjen e asamblese se ortakve te shoqerise " GERVIS ' shpk , kemi marre vendim ne keto kushte i jemi drejtuar gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane me ane te kesaj kerkese se dhe me vullnetin e lire e te plote e firmos Une , noteria pasi bindem per vullntin e lire e te plote e legalizoje ate sipas ligjit.




Notere
Aferdita HAXHIA



Emri	Fatos
Mbiemri	Vlaminari
Emri i babait	Fati
Emri i nënes	Maiko
Data lindje	25.04.1954
Vendlindja	Groshë
Vendbanimi	Rajoni i Tirane
Kombesia	Shqiptare
QH Nr. 331120	

Leshur në bazë të regjistrit themeltar të shtetasve	
Nr. i regjistrit të identifikimit	50 120
Data e lëshimit	15.08.1990
Zyra e Gjendjes Civile	Nr. 10
NEPJUNES I GJENDJES CIVILE	



SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" GERVIS " SHPK,
TIRANE
ALBANIA

V E N D I M

**NR 1 DATE 22.02.2006
I ASAMBLESE SE SHOQERISE**

Sot me date 22.02.2006 ne selin e shoqerise " GERVIS " shpk me adrese ne rruga " Budi " ne mbledhjen e asamblese me pjesemarrjen e 100% te ortakve mori ne analize gjendjen e zhvillimin e aktivitetit te shoqerise se saje sipas rendit te dites dhe vendosi :

v e n d i m se

Asambleja e ortakve me Vendim nr 1 te dates 22.02.2006 ne selin e shoqerise " GERVIS " shpk me adrese ne Tirane rruga " BUDI " ne mbledhjen e saj pas nje analize per gjendjen dhe zhvillimin e aktivitetit te shoqerise sipas rendit te dites u vendos :

1-BEHET LARGIMI I ortakut ,z. BARDHYL VLLAMASI dhe mbetet ORTAK I VETEM z. FATOS VLLAMASI .

2 - BEHET SHITBLERJA e kapitalit brenda ortakerise se shoqerise ;

a- Bardhyl VLLAMASI I shet z. Fatos VLLAMASI 50% te kapitalit te tij themeltar .
b- Fatos VLLAMASI I blen z. Bardhyl VLLAMASI shumen prej 50 % te kapitalit dhe ne keto ai ka shumen 100 % te kapitalit themelare te shoqerise ose baras me 100 000 leke .

3- ADMINISTRATORI I RI I shoqerise do te jete z. FATOS VLLAMASI
3-Ndryshime te tjera nuk ka .

4- Ngarkohet Administratori te ndjek ne gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tirane te depozitoje vendimin e asamblese se ortakëve te shoqerise .
Bashkangjitur eshte vendimi i asamblese se ortakve dhe kontrata e shitblerjes se kapitalit te shoqerise " GERVIS " SHPK Tirane

Fatos Vllamas
Fatos



SHPK " GERVIS "

Ortakët


Bardhyl Vllamas
Bardhyl



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 656 REP
Nr 157 Kol

VERTETIM

Ne , Tirane sot me date 22.02.2006 ne zyren e noterise u paraqite personalisht 1-z.FATOS VLLAMASI i biri i Fahriut i datelindjes 25.08.1954 me nr QH331120 te dokumentit te identitetit tetije personal me banim ne Tirane me cilesin e Administratori dhe ortakut te vetem shpk " GERVIS " ka zotesi te plote juridike per te vepruar eshte madhor ,
2- z. BARDHYL VLLAMASI i biri i Fahriut i datelindjes 25.08.1956 me nr QH331120 te dokumentit te identitetit tetije personal me banim ne Tirane me cilesin e Administratori dhe ortakut te vetem shpk " GERVIS " ka zotesi te plote juridike per te vepruar eshte madhor me deklarojne se ne mbledhjen e asamblese se ortakve te shoqerise " GERVIS ' shpk , kemi marre vendim ne keto kushte i jemi drejtuar gjykates se se Rrethit Gjyqsor Tirane dhe me vullnetin e lire e te plote e firmos Une , noteria pasi bindem per vullntin e lire e te plote e legalizoje ate sipas ligjit.



Notere
Aferdita HAXHIA

REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE Tirane

Nr. 657 Rep

Nr. 158 Kol

KONTRAT SHITBLERJE

KAPITALI - KUOTE

Ne Tirane sote me daten 22.02.2006 para meje Noteres Aferdita Haxhia me adrese ne Rrugen " H. Tahsim " , me nr telefon e fax 224754 ose0692112127 u paraqiten palet kontraktuse per shitjen e kapitalit, kuotave te shoqerise dhe kerkuan redaktimin e kesaj kontrat shitje te pasurise se luajtshme.

PALA SHITESIT:

1- **BARDHYL VLLAMASI** i biri i Fahriut i datelindjes 23.03.1960 i njohur me ane te dokumentit te identitetit tetije personal me banim ne Tirane me cilesin e ortakut te shpk " GERVIS " ka zotesi te plote juridike per te vepruar eshte madhor

PALA BLERESI :

1- **FATOS VLLAMASI** i biri i Fahriut i datelindjes 25.08.1954 me nr QH331120 te dokumentit te identitetit tetije personal me banim ne Tirane me cilesin e Administratori dhe ortakut te vetem shpk " GERVIS " ka zotesi te plote juridike per te vepruar eshte madhor .

Pala shitesese eshte e njohur pronare me vendim Nr 19098 date 24.03.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .

BAZA LIGJORE ;

Ligji 7667 date 28.01.1993 dhe 7638 date 19.11.1992 , eshte e njohur pala blerese me vendim te Asamblese se otakeve me date 22.02.2006 te shpk " GREVIS " Tirane me cilesin e blesit .

Shitesit , Bardhyl Vllamasi pronare e bashkepronesi te kapitalit themltar te shoqerise " GERVIS " shpk , Tirane ,kjo pronesi vertetohet me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr 19098 date 24.03.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .

Ne mbledhjen e asamblese se ortakve eshte vendosur nga te dy palet vullnetarisht largimi i ortakut Bardhyl Vllamasi dhe te behet kalimi pronesie nepermjet shitblerjes , nga pala shitesese tek pala blerese te pjeses se kuotes – kapitalit themeltare te shoqerise me palen blerese dhe FATOS VLLAMASI , sipas vendimit te asamblese se ortakve.

Fatos Vllamasi
[Signature]

Bardhyl Vllamasi
[Signature]



Pala Blerese :- Fatos Vllamasi blene nga ish ortakut themelues ,
kuoten - kapitalin prej 50% ose me cmimin prej = 50 000 leke .
Deklarojne palet se jane korrekt ndaj njeri tjetrit u likujdun pa kushte e veretje
dhe me vullnetin e tyre te lire e te plote e firmosin ate para meje .
Ne keto kushte pala blerese zoteron gjithsej 100 % te kapitalit fillestar te
shoqerise " GERVIS " shpk , Tirane .
Kuota - kapitali themtare prej 100 000(njeqind mije) leke me neshkrimin
e kesaj kontrate shitje behet prone e ortakut te vetm te shoqerise "
GREVIS" shpk ne keto kushte ka te drejte z. Fatos Vllamasi te bej
regjistrimin e kapitalit ne zyren e regjistrimit tregetare prane Gjykates se
Rrethit Gjyqsor Tirane ne emer dhe per llogarine e tij

Kontrata redaktohet ne tre kopje me fuqi te barabarte vepruse e lexojne
palet kontraktuse dhe e kuptojne qarte dhe me vullnetin e tyre te lire e te
plote e firmosin ate, dhe une notere pasi bindem per vullnetin e tyre e
legalizoj sipas ligjit.

PALET KONTRAKTUSE

SHITESI

Bardhyl Vllamasi

BLERESI

Fatos Vllamasi

NOTERI

Aferdita Haxhia

